

# AKT THEMELIMI

## I

### SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" EcoBashkë" SH.P.K

Sot, më datë 26.12.2024,

**Agim Prroni**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 24.04.1969, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034016636 dhe Nr. Personal *G90424078H* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% të kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

#### NENI 1

##### Themelimi

Emri i shoqërisë është "**EcoBashkë**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**EcoBashkë**" Sh.P.K.

#### NENI 2

##### Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Mbledhjes, grumullimit dhe shitjes se materialeve të kartonit, plastikes dhe aluminit.

#### NENI 3

##### Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**EcoBashkë**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

#### NENI 4

##### Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë: Mbledhjes, grumullimit dhe shitjes se materialeve të kartonit, plastikes dhe aluminit.

#### NENI 5

##### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Rruga Dasho Shkreli, Lagjja Guerrile, Zona Kadastrale 8592, Nr.pasurie 20/281.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100,000** (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë ku kuota ka vlerën 100,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin "**EcoBashkë**" **Sh.P.K** zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Agim Prroni**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 24.04.1969, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034016636 dhe Nr. Personal *G90424078H* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% të kapitalit ku një kuotë ka vlerën 100,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

## NENI 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 8

### Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

## NENI 9

### Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet **Z Agim Prroni**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 24.04.1969, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034016636 dhe Nr. Personal *G90424078H* me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi të kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



#### **NENI 10**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 12**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduajnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13**

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Agim Prroni**

